



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:063016
Datë: 28.03.2024
Numri i dokumentit: 05518284

C.nr.890/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Edije Sezairi, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.J., G.K., D.B. dhe B.H. të cilët me autorizim i përfaqëson av. A.H. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, për shkak të kompensimit të shujtave ditore, vlera e kontestit 1,554.00 €, me datën 28.03.2024, morri këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.J., G.K., D.B. dhe B.H. nga Prizreni, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit në emër të shujtave ditore të paguaj shumat sin ë vijim:

- për padësin N.J. për 185 ditë pune për vitin 2022, nga 2 € në ditë, t'ia paguaj shumën prej 370.00 €, me kamatë ligjore prej 8% nga data e paraqitjes të padisë (10.03.203);

- për padësin G.K. për 185 ditë pune për vitin 2022, nga 2 € në ditë, t'ia paguaj shumën prej 370.00 €, me kamatë ligjore prej 8% nga data e paraqitjes të padisë (10.03.203);

- për padësin D.B. për 185 ditë pune për vitin 2022, nga 2 € në ditë, t'ia paguaj shumën prej 370.00 €, me kamatë ligjore prej 8% nga data e paraqitjes të padisë (10.03.203);

- për padësin B.H. për 222 ditë pune për vitin 2022, nga 2 € në ditë, t'ia paguaj shumën prej 444.00 €, me kamatë ligjore prej 8% nga data e paraqitjes të padisë (10.03.203);

Në shumën e përgjithshme prej 1,554.00 euro,

të gjitha brenda afatit prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim e përmbarimit të dhunshëm.

II. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia paguajë shpenzimet procedurale në shumë prej 134.00 euro, në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Ar sy e t i m

Paditësit N.J., G.K., D.B. dhe B.H. të cilët me autorizim i përfaqëson av. A.H. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA), për shkak të kompensimit të shujtave ditore.

E paditura duke vepruar sipas aktvendimit të gjykatës, me datën 30.10.2023 ka dorëzuar në gjykatë përgjigjen në padi me anë të së cilës e ka kundërshtuar në parim padinë dhe kërkesë padinë me arsyetim të mungesës së mjeteve buxhetore ngase Ministria e Financave nuk ka kod të posaçëm buxhetor për këtë kategori të shpenzimeve.

Paditësi padisë ia ka bashkangjitur provën materiale, vërtetimin nr.29, nr.29/1, nr.29/2, nr.29/3, të datës 13.11.2023 e lëshuar nga e paditura Gjymnazi “Gjon Buzuku”, Prizren, me të cilët vërtetimet vërtetohen ditët e punës për paditësit.

Nga provat e administruara më lartë nuk është kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura Gjymnazi “Gjon Buzuku”, Prizren, por mbetet kontestues fakti se paditësit a i takon kompensimi për ushqimin ditor shujtat për të cilën çështje gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar për shkak se kjo kërkesë e paditësit është e rregulluar me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë 013 nr.2056 datë 18.04.2017 konkretisht të nenit 35.7 i cili rregullon të drejtën për shujta ushqim ditor për ditët e kaluara në punë, në rastet kur punëdhënësi nuk e ka organizuar ushqimin në punë sikurse në rastin konkret.

Duke u bazuar në këto dispozita materiale të cilat përcaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palët ndërgjyqëse dhe gjendjen faktike të vërtetuar, se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar kërkesë padinë e paditëses, ashtu që e detyroi të paditurën që paditëses t’ia kompenzon ushqimin ditor në shumën më detalisht të vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke llogaritur një ditë pune nga 2 (dy) euro për shkak se provat materiale konkretisht vërtetimi i lëshuar nga vet e paditura vërtetohet se paditësja ka aq ditë pune të përcaktuara gjithashtu detalisht sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit duke llogaritur me kamatë ligjore prej 8 % nga data e paraqitjes të padisë në gjykatë (18.05.2023) bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale bazohet në nenit 449, 452 dhe 453.1 të LPK-së, ku është obliguar pala e paditur që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 134 €, dhe atë në emër të përpilimit të padisë 104 € dhe në emër të taksës për padi 30 €, bazuar në tarifën e OAK-së.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 143 dhe 398 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2023:063016
Datë: 28.03.2024
Numri i dokumentit: 05518284

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.890/23 me datë 28.03.2024

Gjyqtarja
Edije Sezairi

UDHËZIME PËR ANKESË: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.